



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

Franca nderon Ministren e Kulturës me Urdhrin “Oficere e Nderit në Art dhe Kulturë”

2017-08-02 12:20:00



Ministrja e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, znj. Mirela Kumbaro Furxhi është nderuar me urdhrin “Oficere e Nderit në Art dhe Kulturë” nga Ministria e Kulturës dhe Komunikimit të Francës, njëri nga katër titujt e nderuar ministeriale të Republikës Franceze që akordohen për personalitete në Art dhe Kulturë.

Ministrja e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, znj. Mirela Kumbaro Furxhi është nderuar me urdhrin “Oficere e Nderit në Art dhe Kulturë” nga Ministria e Kulturës dhe Komunikimit të Francës, njëri nga katër titujt e nderuar ministeriale të Republikës Franceze që akordohen për personalitete në Art dhe Kulturë. .

Ky titull iu akordua Ministres Kumbaro nga Ministrja e Kulturës dhe e Komunikimit e Republikës së Francës, Audrey Azoulay, me motivacionin për kontribut të lartë në fushën e kulturës dhe të bashkëpunimit shqiptaro-francez.

Znj. Mirela Kumbaro Furxhi ka dhënë një kontribut të veçantë në marrëdhëniet kulturore shqiptare-franceze, përmes promovimit të vazhdueshëm të kulturës shqiptare në Francë dhe në Europë, por edhe forcimit të lidhjeve të bashkëpunimit kulturor në dy vendeve tona në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore si ura komunikimi dhe shkëmbimi të vlerave reciproke.

Kujtojmë se Ministrja Mirela Kumbaro dhe Ministrja Audrey Azoulay nënshkruan në vitin 2016 Deklaratën e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Komunikimit të Francës dhe Ministrisë së Kulturës së Shqipërisë lidhur me bashkëpunimin kulturor.

Urdhri “Oficere e Nderit në Art dhe Kulturë” jepet për persona të veçantë që dallohen për kontribute të larta në fushën e kulturës dhe komunikimit në Francë dhe në botë.